VJENË

# NJËVJETORI I RËNIES Ë FAMILJES JASHARAJ



ultetit Teknik në Universitetin e
nës, zoti Xhemajl Jashari i cili
koi kujtimet për virtytet për së
lli të komandantit legjendar
em Jashari të familjes së tij e të
es së Jasharajve, me çka u tha
agjja Jasharaj ishte me gjithsej
shtëpi dhe 100 banorë ku vend

herët për t i shpallur botërisht luftë okupatorit serb i cili, i ndihmuar nga paramilitarët, e vetë kriminelët Arkan e Dragan dhe nga një arsenal i madh i armatimit të sjellur, pësoi me vrasjen e dhjetëra paramilitarëve dhe policëve serbë. Adem Jashari derisa ishte gjallë,

DEKLARATË E BISHM-IT

# SHQIPTARËT KURRË NUK DO TË HEQIN DORË NGA PAVARËSIA E KOSOVËS

Kryesia e Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë më 7.03.1999 në lokalet e QKSH „A. Moisiu" në Shtutgart ku ishin të pranishëm z. Nikollë Shabani, nënkryetar, z. Shaban Bushati, Sinan Hiseni, Mal Myrtaj, Ing. Adem Salihaj, Rasim Sadiku, Dedë Mirëdita, Banush Hoxha, Adem Selmanaj dhe R. Elezaj lidhur me situatën e krijuar rreth nënshkrimit të Marrëveshjes për Kosovën, në mes tjerash konkludoi si më poshtë:

përkrahet nënshkrimi i Marrëveshjes kalimtare për Kosovën në kuptimin e vetëm nëse ajo faktikisht paraqet një vetëqeverisje reale dhe të pavarur në të gjitha lëmitë jetësore; atë politike, juridike, ekonomike dhe ushtarake;

marrëveshja si e tillë esencialisht nuk e zgjidh drejt dhe definitivisht çështjen e Kosovës dhe as statusin e trojeve tjera etnike, por si një kompromis i imponuar mbi shqiptarët mund të ketë vlerë vetëm nëse implementimi i saj garantohet nga forcat e NATO-s, në të kundërtën ajo do ta komplikonte edhe më tepër gjendjen politike në Kosovë;

Pavarësia e Kosovës mund të arrihet gjatë kësaj periudhe kalimtare nëse faktorët politikë shqiptarë ngriten mbi interesat dhe ambicjet e tyre personale si dhe nëse me një vetdije më të lartë se deri më tani angazhohen me plotë seriozitet që nga kjo marrëveshje të nxirret maksimumi politik në interes të jetësimit në mënyrë rigoroze të shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Kjo marrëveshje në fakt, është sprova më e madhe politike deri më tani për shqiptarët të cilët duhet të tregojnë punë serioze se janë të aftë të krijojnë dhe ndërtojnë shtetin e tyre nacional dhe demokratik, në të kundërtën do të dëshmohej ajo skepsa e faktorëve ndërkombëtarë se „shqiptarët nuk dinë të bëjnë dhe të mbajnë shtet".

Implementimi i kësaj marrëveshjeje për shqiptarët do të thotë se sa me punën dhe angazhimet e tyre për këto tri vite do ta bindin botën dhe faktorin ndërkombëtar mbi arsyeshmërinë e kërkesës së tyre për pavarësi, prandaj, thënë troç, pavarësia e Kosovës më shumë do të varet nga angazhimet tona se sa nga përmbajtja e marrëveshjes së Rambujesë.

Së fundi, kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet nga pala shqiptare e tillë siç është e propozuar dhe pa kurrfarë ndryshimesh në tekstin e saj si dhe në tërësi, dhe se shqiptarët pa marrë parasysh vënien apo jo të nënshkrimit mbi këtë marrëveshje, ata kurrë nuk do të heqin dorë nga pavarësia e plotë e Kosovës dhe Bashkimit gjithëkombëtar!

*Sekretari, Rexhep Elezaj*